

VENDIM
Nr. 980, datë 2.12.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT
TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË
TRANSPORTIT**

*(Ndryshuar me VKM nr. 239, datë 14.4.2021; nr. 675, datë 6.12.2023; nr. 832, datë
26.12.2024; nr. 484, datë 26.6.2026)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e *Drejtorisë së Përgjithshme së Policisë së Shtetit* si njësi zbatuese për projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (QSHAMT).

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, nga njësia zbatuese, *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit*, në masën 275 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milionë) lekë, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit.

3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekë, dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.

3/1. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH, dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023.

3/2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 29 915 490 (njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024.

3/3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 158 747 529 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026.

4. Fondi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i shtohet Ministrisë së Brendshme, në programin “Policia e Shtetit”.

5. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe